



POLITIKA E PËRDORUESVE


Hyrje

Është esenciale për ASK-në që të siguroj çasje të barabarta me informatat statistikore për të gjitha kategoritë e përdoruesve. ASK-ja duhet të jetë e gatshme që të siguroj informata jo vetëm për ministritë, por edhe për përdorues tjerë qendror dhe kompani të mëdha, si dhe për publikun. Duhet të rritet interesi në mes të përdoruesve, të cilët kanë detyra ekonomike si dhe detyra të tjera në lidhje me statistikat, siç është administrata lokale, shkollat, grupet e ndryshme etnike etj. Kjo ka të bëjë me imazhin e ASK-së dhe përpjekjet e saj që të konsiderohet si e pavarur dhe prodhuese e paanshme e statistikave dhe kontribues i procesit demokratik në Kosovë.

Kategoritë e përdoruesve

Është shumë e nevojshme që të zbulohen parimet e nevojave të përdoruesve dhe të bëhet dallimi i kategorive të përdoruesve, të caktohet për secilën kategori produkti i kërkuar dhe në fund të caktohet mediumi i nevojshëm për shpërndarje. Në këtë tabelë janë grupet e përdoruesve.

Figura 1: Kategoritë e përdoruesve



Në të kaluarën qeveria ka qenë përdoruesi kryesor brenda Sektorit Publik dhe kjo do të vazhdon edhe në të ardhmen. Megjithatë, kërkesat komunale janë rritur për planifikimin e tyre lokal. Kuvendi i Kosovës nuk është klient më pak i rëndësishëm. Anëtarët e tij duhet të shërbehen shumë mirë ngase ata janë të zgjedhur nga vet populli. Në një shoqëri demokratike, ata duhet të jenë të aftë për të vendosur mbi një objektivë dhe në baza të pavarura. Në anën

tjetër, ata vendosin për rregullat statistikore dhe ASK-ja varet jashtëzakonisht nga mirëkuptimi i tyre për statistikën.

Kërkesat e gjëra të të dhënave nga Sektori Ndërkombëtar bëhen gjithnjë e më tepër frekuentues. OKB-ja me nën-organizatat e saja, Eurostati, OECD, organizatat tjera ndërkombëtare dhe zyrat statistikore kombëtare (sidomos nga rajoni) i'u nevojiten të dhëna për publikimet e tyre, gjithashtu këto të dhëna u nevojiten qeverive të huaja dhe ambasadave të huaja në Kosovë.


























Sa më parë që informatat statistikore të bëhen disponibël në ASK, aq më tepër sektori i studimit dhe shkencës, Ekonomisë dhe Shoqatave do të kaloj në klient të rëndësishëm.









Së fundi publiku i përgjithshëm: Pa media masive (gazeta, radio dhe televizion) si shumësi informative statistikore, do të jetë praktikisht e pamundur, që të prezantoj rezultatet publike në publik të gjërë. Në plotësim të kësaj, bibliotekat publike dhe sektori i arsimit shërbejnë si një trung i diturisë për shoqërinë. Statistikat zyrtare do t'i kalojnë informatat në dituri nëse atje ka një çasje të informacioneve përmes këtyre kanaleve.

Grupet e përdoruesve dhe nevojat informative të tyre

Si rregull, grupe të ndryshme të përdoruesve kanë nevojë për informata të ndryshme statistikore, dhe njëri mund t'i dalloj ato themelore, të standardizuara dhe informatat specifike të përdoruesve. Tabela në vijim klasifikon nevojat e informatave mbizotëruese sipas grupit të përdoruesve. Natyrisht, secili grup ndonjëherë mund të ketë edhe kërkesa të tjera. Tabela 2 na i tregon nevojat mbizotëruese.

Tabela 1: Nevojat informative sipas grupit përdorues

Grupi përdorues	Lloji i nevojave informative		
	Themelore	Standardizuara	Përdoruesit specifik
A. Sektori Publik:			
- Kuvendi			
- Autoritetet qeveritare			
- Autoritetet rajonale			
- Komunitat			
B. Sektori Ndërkombëtar			
- Organizatat ndërkombëtare			
- Zyrat statistikore kombëtare			
- Qeveritë e huaja			
- Ambasadat			
C. Studimet dhe Shkenca			
- Institutet Studiuuese			
- Univerzitetet			
- Bibliotekat			
D. Ekonomia:			
- Industria			
- Bankimi, sigurimet			
- Shërbimet tjera			
E. Shoqatat:			
- Shoqatat bujqësore			
- Shoqatat industriale			

- Shoqatat tregtare			
- Bashkësitë punëtore			
F. Publiku I përgjithshëm:			
- Arsimi			
- Mediat masive			
- Shoqatat shoqërore			
- Eko. Shtëpiake private			

Nevojat e Informatave themelore korrespondojnë me kërkesat për informata, e bëra nga “mirë-të informuar” në publikun e gjerë, d.m.th. nga lexuesit e interesuar të gazetave ose të studentëve hulumtues që shkruajnë tema për diploma. Në shoqërinë demokratike, secili qytetar ka të drejtë (dhe obligim) që të informoj vetvetën. Pa informata statistikore, nuk është e mundur të ketë kontroll të vendimeve politike. Banorët e vendeve tjera kanë dëshirë që të informahon edhe për fqinjët e tyre, nga interesi i përgjithshëm turistik, apo kur kanë marrëdhënie tregtare, etj. Këto nevoja informative të përgjithshme të publikut korrespondojnë me misionin, që të siguroj “ shifra për secilin”. Kështu që, qëllimi i parë i ASK-së është që të bëjë disponibël informata themelore si një pasuri e publikut. Këto shifra janë pjesë e infrastrukturës së publikut, si për shembull rrugët, dhe çdokush duhet të ketë të drejtë që t’i përdor ato.

Furnizimi i informatave themelore do të thotë konferenca për shtyp, dosjet, broshurat e vogla (p.sh. Kosova në shifra), ato kërkesa për shërbimin e përdoruesve që janë më pak kohë-shpenzuese, gjithashtu edhe bibliotekat e lejuara për publikun, që është për panairë dhe ekspozita, ngjarje dhe bisedime dhe për shpërndarjen e informatave të përgjithshme dhe të shifrave të rëndësishme përmes internetit.

Nën **informatat e standardizuara**, produktet dhe shërbimet është kuptuar që janë të nevojshme në standardizimin i cila mund të përgatitet më kohë dhe të ofrohet në tregun e informatave. Si shembuj janë:

- Publikimet periodike si seritë statistikore, vjetari statistikor, libër-xhepi, por edhe publikimet e vetme tematike.
- Sistemet e zhvilluara për përsëritje të standardizuar si daljet e përgjithsme të të dhënave bazë, tabelat e kryqëzuara të paradefinuara (p.sh. importi/eksporti i mallrave specifike në statistikat e tregtisë së jashtme).

Shumica prej grupeve të përdoruesve janë klient potencial të informatave të standardizuara. Vetëm shtypi dhe ekonomitë shtëpiake nuk i përkasin përdoruesve të rregullt.





































Nevojat e informatave të përdoruesve specifik janë kërkesa për informata që kërkojnë përpilime shumë të veçanta dhe shpesh të detajizuara të të dhënave statistikore, të cilat nuk mund të kënaqen me produktet e standardizuara, kështu që kërkojnë zgjedhje për përshtatshmeritë e tyre. Këto raste përfshijnë kërkesat e shërbimeve kërkuese, analiza të veçanta statistikore të materialit, shërbime këshilluese për projekte individuale, dhe përsëritje të të dhënave dhe nxjerje nga baza e të dhënave statistikore.

Klientët tipik për kërkesat specifike të përdoruesve janë autoritetet publike, organizatat ndërkombëtare statistikore, institutet studiuuese dhe ndërmarrjet e mëdha.

Përdorimi i metodave dhe mediave për shpërndarje

Media më e rëndësishme për shpërndarjen e produkteve të ndryshme statistikore siç është përshkruar në kontekstin e Tabelës 2, janë të paraqitura në tabelën në vijim.

Tabela 2: Lloji i mediumit të të dhënave sipas llojit të produktit

Lloji i produktit	Lloji i mediumit të të dhënave		
	Të shtypura	USB	Interneti
Produktet themelore			
Broshurat			
Fletushka			
Konferenca për shtyp			
Kërkesa të vogla për shërbimin e përdoruesve			
Produktet e standardizuara			
Vjetari statistikor, libër-xhepi			
Buletini mujor			
Raportet mujore, kuartale			
Publikimet tjera vjetore			
Publikimet tematike të parregullta			
Të tjera p.sh. metodologji, nomenklatura			
Katalogu i publikimeve			
Të shtypurat			
Produktet specifike të përdoruesve			
Përpilimi i të dhënave sipas specifikimit të përdoruesve			
Kërkesat e zgjeruara për shërbimin e përdoruesve			
Analizat e të dhënave specifike të përdoruesit			
Përsëritja direkte e të dhënave në baz.dhënave statis.			

Publikimet e shtypura në të kaluarën ishin mediumet mbizotëruese për shpërndarjen e informatave statistikore. Sot mediat tjera si, CD-ROM, USB dhe interneti po përfitojnë mjaft. Edhe pse shpërndarja në formë elektronike po krijon një garë serioze për produktet e shtypura publikimet në formën tradicionale vështirë do ta humbin rëndësinë e tyre në të ardhmen e afërt. Kështu që disa produkte statistikore janë të shtypura nga shtëpitë botuese (ose zyra me pajisje të shtypjes), duke filluar nga produktet themelore deri tek ato të standardizuara. Produktet specifike të përdoruesve, si rezultatet apo analizat e përpilimeve të të dhënave, mund të shtypen në formë të materialit të shtypur nëse kërkohet nga klienti.

USB zë një vend shumë të rëndësishëm në shpërndarjen e të dhënave në ditët e sotme të dhënat përpunohen më shpejt dhe kapaciteti mjaft i madh pra USB do të jenë mediumet për shpërndarjen e të dhënave, të cilat kanë kapacitet jashtëzakonisht të madh janë disponibël më çmim të përballeshme në treg.

Interneti është bërë mënyra më dinamike dhe premtuese që të shpërndahen statistikat. Përderisa numri i përdoruesëve të internetit po rritet çdo ditë në tërë botën, shumë e më shumë përdorues mund të arrijnë përmes këtij mediumi. Veb-faqja Rrjeti i Mbarë Botës (World Wide Web www) e lejon që të shpërndahen informata të përgjithshme si marrëdhëniet publike, çasje në informatat statistikore themelore, daunlodimi (download) i informatave më të detajizuara nga përdoruesit (p.sh. tabelat ose të gjitha publikimet), dhe t'i çasemi bazës së të dhënave statistikore direkte e cila është e lidhur me internet.

Produktet themelore

Produktet themelore si **broshurat dhe fletushkat** duhet të shpërndahen në formën e shtypur dhe në veb-faqen e internetit, përmbajtja mund të adaptohet në formatin e faqeve të internetit, e cila kërkon punë shtesë. Si alternativë, logotipi origjinal i broshurave dhe fletushkave të shtypura mund të ruhen në veb-faqe për daunlodim (p.sh. forma-PDF) nga përdoruesit.

Kumtimi për shtyp mbi rezultatet e reja statistikore dhe ngjarjet e rëndësishme gjithmonë duhet të prezantohen në veb-faqe- pavarësisht nga konferencat për shtyp ku gazetarët marrin informata në formën e shtypur dhe atë të folur. Arsyeja është se disa përdorues sidomos ata gazetarët që kanë munguar, por edhe për personat e interesuar mund të kenë dëshirë që ta lexojnë shtypin origjinal dhe jo atë që është prezantuar në TV apo gazetë. Arsye tjetër për shpërndarjen e konferencës së shtypit në internet është fakti që të gjithë gazetarët mund të informohen në të njëjtën kohë. Që t'ju mundësoj gazetarëve të punojnë për konferencat e shtypit në PC-të e tyre, konferenca e shtypit duhet të ofrohet për daunlodim në format teksti (p.sh. MS-Word).

Përdoruesit e interesuar duhet të kenë rast që ta vizitojnë ASK që të shohin se çfarë lloji i publikimeve dhe produkteve janë disponibël.

Biblioteka statistikore në ASK, jep mundësinë që të përdoret edhe nga publiku. Bibliotekari është i aftë që të ofroj ndihmë rreth përdorimit të statistikave dhe të jetë i gatshëm që të shes produkte statistikore. Bibliotekari, për më shumë, ndihmon në vënjen në kontakt më ekspertët statistikor përgjegjës për kërkesa specifike.

Produktet e standardizuara

Produktet e standardizuara kryesisht janë publikime statistikore (shikoni tabelën 3) duke përfshirë edhe metodologjitë dhe nomenklaturat. Të gjitha ato mund të shpërndahen në formë të shypur, USB apo përmes internetit. Produktet e kombinuara bëhen jashtëzakonisht të përshtatshme, ku publikimet e shtypura përmbajnë më pak shifra por me shumë komente tekstuale, diagrame dhe fotografi. Një CD-ROM ose USB i bashkangjitur siguron të dhëna të cilat janë më të detajizuara, duke i dhënë përdoruesit mundësi që të analizoj të dhëna të më tutjeshme në PC-në e tij ose duke i vënë këto të dhëna në PC-në e tij.

Për publikime, kërkesat e përgjithshme në vijim janë të rëndësishme për shpërndarje të sukseshme:

- Të gjitha publikimet duhet të jenë të dokumentuara mirë në mënyrë që të kuptohen më lehtë dhe ta përjashtojnë mundësinë e keqinterpretimit. Rezultatet statistikore se paku duhen të

interpretohen shkurtimisht dhe- kurdo që është e mundur- të ilustrohen dhe prezantohen indikatorët apo shkallët e rritjes

- Të gjitha produktet duhet të përfshijnë apo referojnë për përskrimet e koncepteve, definicioneve dhe të pyetsorëve të përdorur statistikorë
- Të gjitha produktet duhet të shpërndahen në dy gjuhë zyrtare të Kosovës. Në plotësim të saj është me rëndësi që të prodhohen informatat e caktuara në gjuhën angleze për përdorimin e komunitetit të madh të ndërkombëtarve
- Rezultatet statistikore duhet të jenë të sakta dhe të siguruara me kohë. Nëse rezultatet nuk janë të qëndrueshme, dikush gjithmonë mund të kontrolloj se a është më adekuate që të publikohen këto të dhëna (sepse janë me të mirat që janë) apo jo. Në çdo rast, nëse rezultatet janë preliminare apo nuk janë mjaft të sakta, kjo duhet të qartësohet në publikime. Vetëm rezultatet statistikore që takohen me standarde kualiteti duhet të publikohen si statistika zyrtare.
- Kuptohet që të prodhohen produkte të mira nëse përdoruesit potencial nuk janë në dijeni për gatishmerinë e tyre, nuk janë të informuar mbi kostot e përfshira, apo në mënyrën e porosisë dhe të pagesës. Produktet disponbël, procedurat e porositjes dhe çmimet (duke përfshirë koston e shpërndarë) duhet të jenë transparente për përdoruesit
- Produktet e porositura të standardizuara duhet menjëherë të dërgohen pa ndonjë vonesë

Në vendosjen mbi struktura dhe shumën e publikimeve, duhet të mirren parasysh edhe këto:

- Obligimet e ASK-së në prodhimin e publikimeve të sigurta
- Kostoja e prodhimit të një publikimi
- Mundësia për krijimin e publikimeve me kualitet më të lartë
- Interesi i shoqërisë për publikime (të vendosura nga shifrat e shitjeve dhe përmes kontakteve me përdoruesit)

Në mënyrë që të rritet kualiteti dhe zbritet çmimi i prodhimeve të publikimeve, ndonjëherë mund të jetë përparësi që të konsiderojmë zvoglimin e numrit të publikimeve. Ekzistojnë mundësi të shumta:

- Së pari, të zvoglohet kualiteti i logotipit të disa publikimeve, p.sh. dallimi në mes *publikimet statistikore dhe dokumentet statistikore*. Ku publikimet statistikore do të kenë kopertinën (e fortë) me ngjyrë dhe me përmbajtje sqaruese, interpretime dhe diagrame, ndërsa, dokumentet statistikore do të printohen vetëm bardh e zi. Ky lloj mund të përdoret p.sh. për publikimet mujore.
- Prodhimi i publikimeve të përziera, që përmban publikimet e shtypura që janë zvogluar me CD-ROM
- Prodhimi i një numri të vogël të publikimeve të shtypura dhe shpërndarja e publikimeve përmes internetit
- Ruajtja e të dhënave statistikore në të dhënat bazë dhe sigurimi i të zgjedhurave apo të gjitha rezultateve si të shtypura me kërkesë

Në çdo rast, katalogu i publikimeve të shtypura , produkteve elektronike dhe shërbimeve informative duhet të publikohen, duke indikuar në mënyrë që të gjenden të gjitha llojet e informatave.

Sa i përket strukturës së veb-faqes së internetit, është me rëndësi që këto faqe reflektojnë tek prioritetet e përdoruesve dhe të jenë forma logjike të pikëpamjeve të përdoruesve. Duhet të dihet që interesi kryesor i përdoruesve është të marrin informata statistikore. Duhet të konsiderohet struktura bazë e faqeve tona në internet:

Produktet specifike të përdoruesve

Produktet specifike të përdoruesve janë ato të cilat sigurohen nga shërbimi i përdoruesve në bashkëpunim me subjektet e divizioneve, p.sh. përpilimi dhe analizimi i të dhënave, të cilat janë të siguruar në formë të shtypur, CD-ROM apo në USB. Një produkt tjetër specifik i përdoruesve është baza e të dhënave statistikore ASK- Data ku përdoruesit mund t'i zgjedhin të dhënat e nxjerra përmes internetit. Pra, ASK-ja ofron një bazë të të dhënave statistikore të agreguara me indikatorë social, ekonomik dhe bujqësorë ku kemi shmangur dyfishimin e punës dhe mirëmbajmë koherencën e të gjitha publikimeve pra një hyrje dhe shumë dalje. Të gjitha produktet e shpërndarjes duhet të bëhen nga kjo bazë e të dhënave në të ardhmen që t'i kënaq kërkesat e përdoruesve qeveritarë, jo-qeveritarë dhe ndërkombëtarë.

Forma standarde e aprovimit të kërkesave të veçanta të shfrytëzuesve

Për realizimin e kërkesave të veçanta të shfrytëzuesve, qofshin ata individual apo nga institucionet e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, ASK-ja sipas Ligjit të Statistikave Zyrtare, ka standardizuar Formën zyrtare të aprovimit për përdorimin e të dhënave që ka në disponim.

Kjo Formë standarde bazohet në dispozita dhe nene të caktuara të Ligjit për Statistika Zyrtare dhe vendos proceset se si zbatohen përgjegjësitë e ofrimit të të dhënave dhe qasjes në baza të shënimeve, duke respektuar konfidencialitetin dhe ligjshmërinë e mbrojtjes së të dhënave personale.

Gjatë procesit të realizimit të kërkesave të shfrytëzuesve përmes kësaj forme të standardizuar, stafi kompetent i ASK-së është në disponim të plotë për shfrytëzuesit dhe monitoron gjithashtu gjith procesin e ruajtjes së konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave të ofruara.